



Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!

Rrethanat dhe mjedisi ndikojnë mbi ne, por ne jemi përgjegjës për vetveten.

Paulo Coelho

Në këtë buletin do të gjeni:

Fushata ndërgjegjësuere për përmirësimin e gjendjes në mjedis

Monitorimet mjedisore

Faqe 1

Sensibilizimi i shkollave 9- Vjeçare

Ndarja në burim e mbetjeve të kartonit/letrës

Faqe 3

Raportimet në Agjencinë Europiane të Mjedisit

Dita ndërkombëtare e Tokës

Faqe 2

Takime me biznese për mospërdorimin e qeseve mbajtëse plastike

Faqe 4

Rubrika

“Mesazhe Ndërgjegjësuere”

Faqe 4

Fushata ndërgjegjëse për përmirësimin e gjendjes në mjedis

Kjo fushatë ka filluar në muajin tetor të vitit 2021 dhe është finalizuar në Shkurt të vitit 2022. Janë realizuar takime me 61 bashkitë e vendit dhe 22 biznese.

Synimi i takimeve ndërgjegjëse ishte:

- Njohja me vlerësimin e gjendjes së mjedisit në vendin tonë për vitin 2020
- Informimi me rekomandimet e dhëna në RGJM 2020, për përmirësimin e situatës mjedisore, me qëllim përfshirjen e tyre në dokumentat strategjike dhe planet vendore për mjedisin të bashkive. Ndërgjegjësimi për ndërmarrjen e veprimeve të rekomanduara.
- Ndërgjegjësimi i bizneseve me aktivitet industrial për ndikimet negative që shkaktohen në mjedis dhe njohja me rekomandimet për minimizimin e tyre në mbrojtje të mjedisit.
- Nxitjen e tyre për përdorimin e teknologjive më të mira dhe trajtimin e shkarkimeve në ajër, tokë dhe ujë.



Rekomandimet e Raportit të Gjendjes në Mjedis, ndihmojnë në hartimin e politikave më efikase dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura, jo vetëm në përmirësimin e gjendjes së mjedisit, por edhe në parandalimin e ndikimeve në mjedis.

Monitorimet mjedisore

Laboratori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në mbështetje të VKM Nr.1189 datë 18.11.2009 për “Rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit” pika B 4.1 a-f, B 4.2 a – b, Ç 4-b si dhe në zbatim të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit realizon programet me temë:

1. “Monitorimin e cilësisë së ujërave sipërfaqësore të Shqipërisë në lumenj, liqene dhe zona bregdetare si dhe ndikimi i shkarkimeve të lëngëta urbane në cilësinë e tyre për vitin 2022”.

2. Monitorimi i Zhurmave në Qytetet: Tiranë, Vlorë, Fier, Korçë, Berat, Gjirokastrë, Sarandë, Pogradec, Shkodër, Kukës dhe Lezhë” për vitin 2022

Monitorimi i ujërave sipërfaqësore - Rrjeti i monitorimit është i shtrirë në gjithë territorin e Shqipërisë i ndarë sipas baseneve Baseni i Drinit, Baseni i Matit, Baseni Ishëm – Erzen, Baseni i Shkumbinit, Baseni i Semanit, Baseni i Vjosës dhe është i përbërë si vijon:

- 38 stacione në lumenjtë kryesore të vendit Drin, Bunë, Mat, Ishëm, Erzen, Seman, Shkumbin dhe Vjosë.
- 3 stacione për tributarët e liqenit të Ohrit
- 10 stacione në liqenet natyrore, Ohër, Shkodër, Prespë, Prespë e Vogël dhe Laguna e Butrintit
- 4 stacione lagunore në Lagunën e Karavastasë dhe Nartë.

Klasifikimi i cilësisë së lumenjve dhe liqeneve kryhet bazuar në vlerat limite të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit (DIRECTIVE 2000/60/EC OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 23 Tetor 2000) ku kjo Direktivë i klasifikon ujërat në pesë klasa ku **Klasa III - Gjendja e moderuar konsiderohet si klasa me nivel minimal të pranueshëm të cilësisë së ujërave**, ku për të gjithë basenet vlerësohet statusi kimik.

Gjatë periudhës Shkurt – Prill është realizuar ekspedita e parë e monitorimit të cilësisë së lumenjve në të 38 stacionet e monitorimit në basenet kryesore të Shqipërisë.

Treguesit që monitorohen: temperatura e ujit, pH, alkalinitet, saliniteti, përcjellshmëria elektrike, oksigjeni i tretur, NKO, NBO₅, nitritet, nitratet, amonjaku, orto – fosfatet, P_{total}, lënda pezull

Monitorimi i zhurmave urbane - Monitorimi kryhet bazuar në Legjislacionin Shqipëtar dhe Direktivat Europiane për zhurmat me Sound Level metër Testo 816-1 i cili është një matës i nivelit të zërit me një interval matës prej 30 deri në 130 dB, me dy pesha kohore dhe dy pesha frekuence, dhe me një korigjim ± 1.4 dB (A) dhe si kalibrator i zërit 0554 0452 për kontrollin e saktësisë së pajisjeve.

Në varësi të situatës, zhurmat nga trafiku rrugor mund të klasifikohen si një burim i vazhdueshëm ose si shumë e ngjarjeve të vetme të përsëritura, monitorimi i zhurmave të prodhuara prej tij llogaritet brenda intervaleve kohore të referencës kur kontrollojmë përputhjen me limitet (ISO1996-1). Ky monitorim përgjatë kësaj periudhe është realizuar në Sarandë, Vlorë, Pogradec, Lezhë, Korçë, Berat, Gjirokastrë, Shkodër, vetëm për ekspeditën e parë.

Raportimet në Agjencinë Europiane të Mjedisit


Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pjesë e Rrjetit Europian të Vëzhgimit dhe Informacionit Mjedisor të Agjencisë Europiane të Mjedisit, për vitin 2021, e rriti ndjeshëm performancën e saj të Raportimeve Mjedisore mbi gjendjen dhe cilësinë e mjedisit në Shqipëri, në 86%. ✓

Specialistët e AKM në bashkëpunim me ata të institucioneve të tjera monitoruese në nivel kombëtar, ja arritën që të vendosin një standart të ri në përmbushjen e detyrimeve raportuese të Shqipërisë drejt institucioneve të Bashkimit Europian, Agjencine Europiane e Mjedisit. Kjo, falë punës dhe përkushtimit të gjithë atyre që edhe në kohë pandemie dhe vështirësish, ju përgjigjën me seriozitet e përkushtim detyrimeve tona drejt EEA, në përmbushje të kërkesave e detyrimeve të diktuar nga legjislacioni mjedisor europian dhe në linjë me proceset integruese të vendit drejt BE dhe institucioneve të saj.

Sfida të tjera dhe ende shumë punë përpara nesh.

Për më shumë informacion klikoni linkun e 👉

<https://www.eionet.europa.eu/dataflows/2021/>



Dita ndërkombëtare e Tokës

Dita e ndërkombëtare e tokës ,22 prill

Misioni i Ditës së Tokës është të edukojë dhe të nxitë lëvizjen mjedisore në mbarë botën. Tema për këtë vit është “Investo për Planetin tonë”. Në kuadër të kësaj dite [Agjencia Kombëtare e Mjedisit](#), mbolli fidanë dekorativë pranë ambienteve të saj.



Aktivitete në natyrë: Dita e Tokës



Një tjetër aktivitet ishte takimi sensibilizues me nxënës të shkollave 9- Vjeçare në Tiranë mbi rëndësinë e përdorimit të resurseve natyrore në mënyrë të kontrolluar, për të ruajtur Planetin Tokë duke u orientuar drejt qëndrueshmërisë mjedisore.

Së bashku, me mësues e nxënës diskutuam edhe prezantuam mbi disa module edukimi për mirëmenaxhimin e mbetjeve, ekonominë qarkulluese, dhe reduktimin e përdorimit të plastikës njëpërdorimshme.

Sensibilizimi i shkollave 9- vjeçare

Agjencia Kombëtare e Mjedisit, gjatë muajit Prill, ka organizuar shumë aktivitete në kuadër të sensibilizimit për mbrojtjen e mjedisit.

Një nga sfidat kryesore të mjedisit, është menaxhimi i mbetjeve, dhe edukimi i të gjithë qytetarëve, bizneseve dhe grupeve të interesit, në lidhje me eliminimin e qeseve plastike njëpërdorimshe, për të cilin Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka ndërmarrë së fundmi këtë nismë, e cila do të finalizohet me zbatimin e ligjit për ndalimin, prodhimin, importimin dhe përdorimin e qeseve plastike në Shqipëri.



Në kuadër të kësaj fushate, AKM ka kryer takime me mësues të shkollave 9-vjeçare për prezantimin e disa moduleve edukuese në lidhje me këto tema, të cilat do të orientojnë dhe ndihmojnë mësues-nxënës- komunitet se si të arrijmë të ndikojmë pozitivisht në përmirësimin e situatës së mbetjeve, përfitimin e njohurive mbi konceptet e menaxhimit të mbetjeve, eliminimit të plastikës, ekonomisë qarkulluese, rikuperimit të energjisë dhe ndikimet e gjithësecilit nga ne në mjedis.



Gjithashtu u njohën me përfitimet e procesit të riciklimit të rrymave të ndryshme të mbetjeve duke përmendur mbetjet e letrës/kartonit, mbetjet plastike si dhe mbetjet e baterive. Cilat janë efektet negative në shëndet dhe mjedis nëse këto mbetje hidhen në mënyrë të pakontrolluar.

Ndarja në burim e mbetjeve të kartonit/letrës

Në bashkëpunim me projektin e GIZ “Menaxhimi i Modernizuar i Mbetjeve të Ngurta dhe Ekonomia Ricikluese në Respekt të Mjedisit” gjatë muajit Mars është realizuar ndërgjegjësim i vazhdueshëm në supermarket/markete, apo institucione të caktuara nga projekti i GIZ në qytetet Cërrik dhe Sarandë.

Takimet kishin si qëllim ndërgjegjësimin e tyre për hedhjen e diferencuar të mbetjeve në koshat e caktuara nga projekti i GIZ. Njohjen me problematikat dhe vështirësitë e tyre për realizimin e ndarjes në burim të mbetjeve që gjenerojnë.



Në përgjithësi diferencimi i mbetjeve të kartonit/letrës realizohet nga të gjithë supermarket/markete apo institucionet e përzgjedhura por kërkohet përmirësim në tërheqjen e rregullt të këtyre mbetjeve për të vijuar me procesin e riciklimit.

Një problematikë tjetër është se në disa raste për shkak të volumit të madh dhe sasisë të gjeneruar të mbetjeve kërkohet shtimi i koshave për ndarjen në burim të mbetjeve të kartonit/letrës.

Unë mjedisin

Pse duhet të ndajmë mbetjet e letrës/kartonit?

Ndarja e mbetjeve të kartonit/letrës ndihmon në procesin e riciklimit të letrës. Kjo është një praktikë e përhapur gjerësisht dhe duhet të bëhet nga të gjithë ne, me qëllim zvogëlimin e mbetjeve dhe shpëtimin e pemëve për të krijuar një eko-qëndrueshmëri të planetit.

Në këto koshat e rrjetës duhet të vendosen mbetje:

- Revista dhe libra
- Ambalazhi i vezëve
- Karton

SHQIPËRIA RIKIKLON

Takime me biznese për mospërdorimin e qeseve mbajtëse plastike

Gjatë muajit prill, krahas ndërgjegjësimit për ndarjen në burim të mbetjeve të kartonit/letrës, pjesë e diskutimeve të takimeve në supermarkete/markete ishte dhe ndërgjegjësimi për mospërdorimin e qeseve plastike mbajtëse të pariciklueshme.



Synimi i takimeve ndërgjegjëse konsiston në arritjen e objektivit referuar Ligjit Nr 28, datë 17.03.2022, ku përcaktohet se duke filluar nga **1 Qershori** ndalohej përdorimi i qeseve plastike mbajtëse transportuese me ose pa vesh, e prodhuar nga plastika, me trashësi për çdo anë më të vogël se 70 mikron dhe me kapacitet mbajtës më të vogël se 10 kilogramë.



Nxitja e tyre për përdorimin e çantave prej material tekstili. Një mënyrë alternative për të qenë më miqësor me mjedisin



"Mesazh Ndërgjegjësues"

Për një mjedis të pastër gjatë sezonit veror 2022!

- ✓ Gjatë sezonit veror të vitit 2021 u konstatua se ka pasur një fluks të shtuar pushuesish pothuajse gjatë bregdetit të Shqipërisë.
- ✓ Duke u bazuar në rezultatet e monitorimit mikrobiologjik, ka ende plazhe ku ka ndotje mikrobiale.
- ✓ Shkaktar kryesor të ndotjes në ujërat bregdetarë të larjes mbeten shkarkimet e ujrave urbane të patrajtuara në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte.
- ✓ Një tjetër shkaktar për ndotjen mbeten impiantet e pastrimit të cilat trajtojnë ujërat e ndotura, ato duhet të jenë në punë vazhdimisht.

Për një sezon turistik veror më cilësor për vitin 2022 rekomandohet:

- ❖ Marrja e masave nga Pushteti Lokal kudo ku ka ujëra larës, në zonat e cilësuar të ndotura për trajtimin e ujrave urbane, para se ato të shkarkohen në det.
- ❖ Informimi i publikut mbi cilësinë e ujrave bregdetarë të larjes dhe vendosja e tabelave informuese në kohë reale.
- ❖ Marrja e masave nga Pushteti Lokal për vendosjen e tualeteve, shtimin e koshave të mbeturinave, të dhomave të ndërrimit, kullave të vrojtimit, në plazhet publike.
- ❖ Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave inerte si dhe mbeturinave urbane në plazhe.
- ❖ Vënia në funksionim me efikasitet të plotë dhe zgjerimi i kapaciteteve të Impianteve të Trajtimit të Ujërave Urbane që janë në funksion, dhe ngritja e Impianteve të Trajtimit të Ujërave në zona të vogla banimi.
- ❖ Kontroll më i rreptë në plazhe nga Autoritetet kompetente (Inspektoriatet) për ruajtjen e mjedisit nga mbetjet urbane dhe inerte si dhe për zbatimin e rregullave higjieno-sanitare.

ko
sha
t e
ca
ktu
ar
nu
k e
për
bal
loj
në
plo
tës
ish
t

